



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. ____ Prot.

Tiranë më, _____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT “Rikonstruksion Objekti, Heqje dhe Furnizim-Vendosje Dyer dhe Dritare për FSHMT, Tiranë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Dritare, dyer dhe elemente të ngjashme-44221000-5, Punime ndërtimi-45210000-2, Instalime të dyerve dhe dritareve dhe komponentëve të ngjashëm- 45421100-5, Instalime dyersh dhe korniza dritaresh-45421110-8, Instalime të dyerve-45421131-1, Instalime të dritareve- 45421132-8, Lyerje ndërtesash- 45442110-1, Punime fasadash-45443000-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 36,912,500 (tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, autoriteti/enti kontraktor, Njësia e Prokurimit, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) *Formulari i ofertës dhe çmimit, sipas shtojcës 1 dhe 2;*
- b) *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c) *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.*

Argumentim: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP I ndryshuar, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

1. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë, të mjedisit dhe të cilësisë në saldim. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

- Certifikatë **ISO 9001:2015** ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
- Certifikatë **ISO 45001 - 2018** ose ekuivalente mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim;
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Kerkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit” si dhe bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci

extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me license leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit” si dhe bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është “e Hapur”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenit 43, pika 2, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: “Vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”*. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024 ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastiit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- b. dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 40 % e fondit limit të lotit për të cilin konkuron dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- c. dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i fondit limit.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

2.3.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
 - Fatura tatimore perkatese
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit te kontrates si dhe natyra e punes se kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim;
 - Fatura tatimore perkatese.

Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomik si dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit.

Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Referuar VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me *Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, Kreu XI, Neni 88, pika 3, citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”*AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” ku qartazi përcaktohet se: *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me *Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024*, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e sukseshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur

vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa më të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private lëshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nënkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkepunimit; me marreveshjen e nënkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nënkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene palë në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qenë Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesmarrjes së OE në tendër as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikojnë legjislacionin e prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”* (e ndryshuar), ku ndër të tjera përcaktohet se: ***Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.***

3. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi për kategoritë e mëposhtme:

- NP - 3 A Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale.
- NS - 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve.
- NS - 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to etj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar me *Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”*, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”* të ndryshuar me *Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024*, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”* të ndryshuar, neni 8 përcakton *“Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.*

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	kategorisë sipas legjislacionit të fushës Pershkrimi i	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-3 A	Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industrial, veshje fasada	Totali i punimeve për gjith objektin meqënëse është Rikonstruksion	21 - 50 milionë	38,000,000 Leke
NS - 1 A	Punime për prishjen e ndërtimeve	Sipas preventivit zeri numer 1 , 2 , 3 dhe 7	0 - 20 milionë	1,096,824 Leke
NS - 4 A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to etj	Sipas preventivit zeri numer 4 , 5 , 6 ,8 , 9 , 10 dhe 11	21 - 50 milionë	35,093,652 Leke

4. Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar i të paktën 35 (tridhjet e pesë) personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar.
- b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen e fundit te deklaruar,

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit).

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv.

Numri i stafit kryesor dhe mbështetës është llogaritur në baze të volumeve dhe grafikut të punimeve.

5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të perfshire ne licensen e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi, i cili duhet të jetë drejtues teknik i shoqërisë.**
- **1 (një) Arkitekt.**

Shënim: Bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin objektiv në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të preventivit për secilin nga zërat e punimeve dhe për cilësinë e materialeve që vendosen në objektet ku do të kryhen punimet.
- **Arkitekti** për faktin që natyra e punimeve, për zërat kryesore të preventivit që është vendosja e dritareve dhe vetratave d/al plastik, të cilat afektojnë me fasadat e jashtme të objekteve arsimore, prandaj rezulton se duhet patjetër që përzgjedhja dhe kombinimi i modeleve të dritareve dhe vetratave dhe ngjyrave të përzgjedhura të realizohet nga një specialist i kualifikuar.

6. Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë nga (Administratori i shoqërisë), Përgjegjësin Teknik të Kantierit, i cili do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Përgjegjësi Teknik i Kantierit, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) **Librezë pune;**
- b) **Kontratë pune e vlefshme;**
- c) **Diplomë.**

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Kreun I/2.1 të Udhezimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit“, përcaktohet se “Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.

Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese, si provë paraprake do të mjaftojë deklarata.

7. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

- a) 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave").
- b) 1 (një) punonjes me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 2 (dy) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").
- c) 2 (dy) punonjës me çertifikatë Punime ne Lartesi që të disponojnë çertifikatë trajnimi “Për punime në lartësi”, sipas V.K.M nr.312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Shënim: Bazuar në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punes (tituli dipomes/certifikates se kualifikimit), numri amzes, institucionin qe ka leshuar kualifikimin perkates

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që

lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës. “Ekspert për ndihmë e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” duhet të jetë në kantier në rast aksidentesh në punë. Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” duhet të jetë në kantier për marrjen e masave parandaluese të aksidenteve në punë.

8. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/dëshmi certifikate profesionale përkatëse leshuar nga institucione publike/private, të licencuara/akredituara, të njohur nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, si më poshtë:

- 1 (një) punonjës teknik ndertimi
- 2 (dy) punonjës suvatues
- 2 (dy) punonjës bojaxhi
- 16 (gjatëmbledhjet) punonjës specialistë duro-alumini/plastik PVC

Për stafin teknik ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale e punës;
- b) diplomën/dëshminë, që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm leshuar nga institucionet e akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore në Republikën e Shqipërisë;

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mësipërm, emer/mbiemer, profili i punës (titulli i diplomës/certifikatës së kualifikimit), numri amzes, institucionin që ka leshuar kualifikimin përkatës.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse leshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licencuara nga ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialistëve duhet të jenë të regjistruara në “*regjistrat profesionale*” të AKAFP-se. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto

punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Teknik ndertimi** është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme, dhe disa zëra të veçantë të preventivit realizimi i të cilave kërkon staf të specializuar është gjykuar që të paktën 1 (një) teknik ndertimi i kualifikuar është i nevojshëm për realizimin e kontratës.
- **Punonjës Suvatues** janë vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme, është gjykuar që të paktën 2 (dy) punonjës murator/suvatues të kualifikuar janë të nevojshëm për realizimin e kontratës.
- **Punonjës bojaxhi** është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme, është gjykuar që të paktën 1 (një) punonjës bojaxhi i kualifikuar është i nevojshëm për realizimin e kontratës.
- **Punonjës duralumini** specialistë D/Al plastik janë vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore njëkohësisht në objekte të ndryshme, është gjykuar që të paktën 5 (pesë) specialistë D/Al plastik duhet të jetë pjesë e stafit teknik për realizimin e kontratës pasi natyra e punës për vendosjen dhe montimin e D/Al plastik kërkon aftësi profesionale të kualifikuara.

9. Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues për materialet (dyert dhe dritare) , duhet të paraqesë: Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve të prodhuesit/ distributorëve zyrtarë ose skedat teknike të publikuara nga prodhuesit/ distributorët zyrtarë, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të mallrave sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse mallrat e ofruara të cilat do të përdoren në kryerjen e shërbimeve, plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Katalogët ose skedat teknike duhet të jenë të noterizuara dhe të përkthyer në gjuhën Shqipe.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të cilat janë të domosdoshme në realizimin e punimeve objekt prokurimi. Në këtë rast është shumë e rëndësishme plotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi kemi të bëjmë me produkte të cilat domosdoshmërisht duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin gjatë përdorimit të tyre në kryerjen e punimeve të ndryshme specifike pasi përdoren në objekte arsimore ku kërkesat e cilësisë dhe të ruajtjes së mjedisit janë të larta.

10. Operatori ekonomik ofertues për (dritaret dhe dyert) objekt prokurimi që do të përdoren në kryerjen e punimeve objekt të kontratës për të cilat kërkohen shprehimisht standarte teknike kombëtare ose ndërkombëtare të publikuara, duhet të paraqesë autorizim prodhuesi

ose distributori. Deklaratë ose Çertifikatë Konfirmiteti CE/ Çertifikatë Ecolabel për këto produkte, të lëshuara nga një organizëm i notifikuar europian/organizëm certifikues i akredituar ose raportet testimi të lëshuara nga organizma të notifikuar europian / organizma testues të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024 dhe Ligji nr.9779, datë 16.07.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin deklarata/certifikata konfirmiteti CE ose dëshmi të testimave zyrtare të cilat provojnë përmbushjen e karakteristikave teknike të mallrave objekt të prokurimit që do të përdoren në punimet e parashikuara dhe të pasqyruara në preventivin e publikuar në DST. Dritaret dhe vettrat do të vendosen në objekte arsimore prandaj siguria e përmbushjes së standarteve teknike të miratuara dhe cilësisë së tyre duhet të maksimale. Materialet që do të përdoren për mirëmbajtjen e objekteve arsimore duhet të jenë ekologjike, cilësore dhe të padëmshme për shëndetin e fëmijëve. Në bazë të rregullave të vendosura nga Vendimi i Komisionit Europian (2014/312/EU) i datës 28 Maj 2014 "Për vendosjen e kriterëve ekologjike për dhënien e etiketës ekologjike të BE-së për bojërat dhe llaqet e brendshme dhe të jashtme", këto produkte duhet të kenë përmbajtje sa më të ulët të përbërësve organikë të avullueshëm (të çlirojnë sa më pak të jetë e mundur), të jenë në përputhje me kriteret ekologjike, të mos përmbajnë metale të rënda apo substanca toksike, të kenë një mbulueshmëri të mirë dhe të jenë rezistenete ndaj faktorëve atmosferikë të brendshëm dhe të jashtëm. Bojrat e përdorura për lyerje të ambienteve të brendshme dhe të jashtme përmbajnë kimikate, të cilët deri më së fundmi janë të rëndësishme për cilësinë dhe karakteristikat e bojës. Ato ndihmojnë në lidhjen e komponenteve, në qëndrueshmërinë dhe në normën e përhapjes së saj. Këto kimikate, të tilla si amoniaku apo solvente të avullueshëm, të quajtur VOCs, kur boja thahet avullojnë, çlirohen nga cipa e tharë e bojës dhe qëndrojnë në ajrin e ambientit të lyer. Ato janë potencialisht të dëmshme, pasi personat që popullojnë këto ambiente thithin ajrin e ngopur me këto avuj. Ato shkaktojnë simptoma akute, duke përfshirë dhimbje koke, të vjella, probleme në rrugët e frymëmarrjes, alergji, etj. Prandaj autoriteti kontaktor e gjykon se këto produkte duhen të jenë të certifikuara nga organizma certifikues të akredituar.

11. Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara, ditën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pranë autoritetit kontraktor një mostër për dritare d/alumini plastike me tre xham.

** Mostrat e paraqitura duhet të jenë prerje ku të evidentohen të gjitha elementet, detajet dhe aksesoret sipas specifikimeve teknike.*

Mosdorëzimi i mostrës për secilën pajisje/material të kërkuar ditën e hapjes së ofertave dhe në rast se mostrat nuk janë në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike e përcaktuara në DST, përbën kusht për s’kualifikim.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” në të cilin, **ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:** “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.**

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e

nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në **nenin 39** “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” **pika 2 dhe 8** të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me *Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024 ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: “2. Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.*

Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Në **nenin 40 pika 6 gërma “a”** të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. **285, datë 19.5.2021** “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me *Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024 ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:*

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose...”

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, referuar materialeve/pajisjeve që do të instalohen në investimin objekt prokurimi, të cilat duhet të jenë sipas standarteve dhe specifikimeve teknike të kërkuara, për shkak të jetëgjatësisë që duhet të kenë si materiale, përtej periudhës së garancisë së punimeve të kërkuar, njësia e prokurimit e vlerëson të rëndësishëm kushtin e paraqitjes së mostrës për këto mallra/pajisje ditën e hapjes së ofertave, **me qëllim që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të ketë mundësinë për të kontrolluar nëse këto materiale/pajisje që do të përdoren në realizimin e punimeve objekt kontrate janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit.**

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenin 15 pika 3/a të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me *Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024 ndër të tjerash parashikohet se: “a) Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën: - grafikun e zbatimit;”*

12. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr.	Kreu I - Mjetet dhe pajisjet teknike	Sasia minimale	Gjendja
1	Kamion me vinç për transportimin e dritareve dhe vetratave në objekte	1 copë	Pronësi ose me qira
2	Automjet me kosh në lartësi $\geq 12\text{m}$	2 copë	Pronësi ose me qira
3	Karroçë dore $\geq 80\text{lt}$	2 copë	Pronësi ose me qira
4	Skeleri metalike	1000 m ²	Pronësi ose me qira
5	Minifadrome me goma MT	1 copë	Pronësi ose me qira
6	Gjenerator $\geq 5\text{kw}$	1 copë	Pronësi ose me qira
7	Depozitë uji 1000-3000lt	1 copë	Pronësi ose me qira
8	Sharrë profesionale për D/A plastik	1 copë	Pronësi ose me qira
9	Makineri për ngjitje D/A plastik	1 copë	Pronësi ose me qira
10	Makineri për pastrimin dhe rifiniturën e D/A plastik	1 copë	Pronësi ose me qira
11	Frezë profesionale për frezimin e fermave në D/A plastik	1 copë	Pronësi ose me qira
12	Pantograf për hapjen e bravave në D/A plastik	1 copë	Pronësi ose me qira
Nr.	Kreu II - Mjetet dhe pajisjet mbrojtëse	Sasia minimale	Gjendja
1	Helmetë mbrojtëse për kokën	20 copë	Pronësi ose me qira
2	Jelekë me shirita fosforishtë	20 copë	Pronësi ose me qira
3	Fikëse zjarri të lëvizshme $\geq 5\text{kg}$	1 copë	Pronësi ose me qira
4	Tabela Sigurimi Teknik	12 copë	Pronësi ose me qira
5	Kuti e Ndihmës së shpejtë	1 copë	Pronësi ose me qira

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b. Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse të qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- c. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- d. Për pajisjet dhe makinerite ngritëse duhet të paraqitet raporti i inspektimit të tyre.
- e. Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

12.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me *Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024*. Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Mjetet dhe pajisjet si më sipër kërkohen referuar zërave të preventivit të punimeve.

Konkretisht mjetet dhe pajisjet e kërkuara, janë si më poshtë :

- 1. Kamion me vinq** për transportimin e dritareve dhe vetratave në objekte për transportimin e dritareve dhe vetratave, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së shërbimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës, sasinë prej minimumi 890 m² dritare dhe vetrata është gjykuar që të paktën 1 (një) mjet i tillë është i nevojshëm për zbatimin e kontratës.
- 2. Automjet me kosh në lartësi ≥12m**, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e punimeve në objekt. Duke patur parasysh se një pjesë e fasadave në objektet arsimore ku do të montohen vetratat e d/al plastik janë të pozicionuara në pamundësi për vendosjen e skelerisë në lartësi, është gjykuar që të paktën 2 (dy) mjet i tillë është i nevojshëm për zbatimin e kontratës.
- 3. Karrocë dore ≥ 80lt**, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së punimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës, sasinë e produkteve të nevojshme për realizimin e kontratës, sasinë e mbeturinava inerte që duhen transportuar nga objektet nëpër vendgrumbullimet provizore të kantierit dhe shpërndarjen në tre objekte arsimore, është gjykuar që të paktën 2 (dy) pajisje teknike të tilla janë të nevojshme për zbatimin e kontratës (një në çdo objekt).
- 4. Skeleri metalike**, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e punimeve në objekte. Duke patur parasysh se një pjesë e fasadave në objektet arsimore ku do të montohen vetratat e d/al plastik duhet të punohet me ndërhyrje nga ana e jashtme e objektit është e nevojshme vendosja e skelerisë në lartësi, prandaj është gjykuar që të paktën 1000 m² janë të nevojshme për zbatimin e kontratës.
- 5. Minifadrome me goma MT** , është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e punimeve në objekte. Duke patur parasysh se do të ket prishje në objekt do te krijohen mbetje inerte , është gjykuar që të paktën 2 (dy) mjete të tilla per ngarikm ne kamioncin dhe sistemim te territorit te objektit jane të nevojshme për zbatimin e kontratës.
- 6. Gjenerator ≥ 5kw**, është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së punimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës, sasinë e dritareve dhe vetratave të parashikuara për montim ku është e nevojshme lidhja e mjeteve teknike montuese me energji elektrike, është gjykuar që të paktën

1(një) pajisje teknike e tillë është e nevojshme për zbatimin e kontratës pasi në raste të paparashikuara mund të ndodhë ndërprerje e energjisë elektrike dhe kjo do të sillte pasoja në përmbushjen me sukses të kontratës në afatin e parashikuar.

7. Depozitë uji 1000-3000lt është vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së punimeve në objekte të ndryshme , duke patur parasysh se ne objekt është nevojshme për uje , dhe është mendur që operatori ekonomik të ketë në dispozicion një depozitë uji .

8, 9, 10, 11 , 12 Sharrë profesionale për D/A plastik, Makineri për ngjitje D/A plastik, Makineri për pastrimin dhe rifiniturën e D/A plastik, Frezë profesionale për frezimin e fermave në D/A plastik, Pantograf për hapjen e bravave në D/A plastik, janë vendosur bazuar në zërat e pasqyruara në preventiv dhe natyra e shpërndarjes së punimeve në objekte të ndryshme. Duke patur parasysh kohën në dispozicion për realizimin e kontratës, sasinë e dritareve dhe vetratave të parashikuara për montim, mjetet teknike të speciale për përpunimin e profileve të d/al plastik konsiderohen të domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës. Mungesa e këtyre mjeteve teknike do ta bënte të pamundur përpunimin mekanik të materialeve dhe montimin e tyre me saktësi dhe cilësi të lartë.

13) Helmetë mbrojtëse për kokën, Jelekë me shirita fosforishentë, Fikëse zjarri të lëvizshme ≥ 5kg, Tabela Sigurimi Teknik, Kuti e Ndhmës së shpejtë, janë kërkuar për të realizuar me efikasitet mbrojtjen dhe sigurinë në punë për punonjësit e nevojshëm për realizimin e kontratës janë kërkuar këto mjete mbrojtëse të pasqyruara në Kreun II të Tabelës në pikën 2.3.12, në përputhje me natyrën e shërbimeve dhe numrin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e kontratës dhe kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Është përllogaritur që sasia e kërkuar të jetë në propocion të barabartë me numrin e objekteve që do të kryhen punimet dhe numrin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e kontratës.

13. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 3 (tre) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda 1 (një) punonjes eskavatorist me goma/ 2 (dy) punonjës automakinist dhe 2 (dy) shofer.

Për punonjesit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi, certifikate e aftësisë profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR. *(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).*

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesit eskavatoriste, automakinist dhe buldozeriste, emer/mbiemer, profil i punes, numri dhe daten e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerise se deshmise së aftësisë profesionale.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtime dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës, sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Gjithashtu Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe preventivin e punimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, ” i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Dokumentet perkatese vertetuese per disponimin e punonjësve do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit te njoftimit te fitesit do t’i kërkojë ofertuesit te kualifikuar nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të paraqitura ne sistemin elektronik të prokurimit gjate fazës së ofertimit. Mosparaqitja e dokumentacionit të sipërcituar do te jete kusht s’kualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s’kualifikimi.

Lidhur me parashikimet e përcaktuara “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, Nj.P. vlerëson se :

Ofertuesve nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e operatorëve të tjerë për plotësimin e kërkesave për kualifikim si më poshtë vijon:

- Kapacitetet ekonomike e financiare, kërkuar sipas pikes **2.2** të Kapacitetit ekonomik e financiar, të Dokumenteve te Tenderit.
- Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës **2.3** të Kapacitetit teknik, pika 1, të Dokumenteve te Tenderit.
- Licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh, kërkuar sipas pikës **3**, të Kapacitetit Teknik.
- Stafit inxhinierik (drejtues teknik) kërkuar sipas pikës **4** të Kapacitetit teknik,dhe stafit te punonjesve te kualifikuar pika **7** të Dokumenteve te Tenderit.

Ofertuesve nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi xhiroja vjetore, përvoja për të zbatuar kontratën, licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh, stafi inxhinierik (drejtuesit teknik) dhe staf punonjes, vlerësohen kapacitete të lidhura ngushtë me shoqërinë dhe tepër të rëndësishme dhe të nevojshme për të krijuar bindjen te AK se ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën sipas standardeve të kërkuara.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me Vendimet Nr. 498, datë 1.8.2024 dhe Vendimin Nr. 545, datë 4.9.2024), duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP i ndryshuar me Ligjin 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT